



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në mbështetjes të nenit 39 dhe nenit 47, paragrafi 1, pika 6 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12 dhe 43/14), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut mori:

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të Regjistrit të Kredive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 74/15)

1. Në Vendimin për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të Regjistrit të Kredive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 186/13), në pikën 1, kryeradha 3, pika zëvendësohet me pikëpresje dhe pas kryeradhës 3, shtohet kryeradha e re 4, si më poshtë:

"- mënyra e qasjes të personave fizikë në të dhënat personale në Regjistrin e Kredive."

2. Në pikën 3, nënpika 3.1., fjalët: ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10 dhe 26/13)" zëvendësohen me fjalët: "("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13 dhe 15/15).

Në nënpikën 3.4., fjalët: ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11 dhe 135/11)" zëvendësohen me fjalët: ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 34/01, 49/01, 103/01, 51/03, 81/08, 24/11, 135/11 dhe 188/13.)".

Pas nënpikës 3.4. shtohen tri nënpika të reja 3.5., 3.6. dhe 3.7., si më poshtë:

"3.5. "E dhënë personale" nënkupton të dhënë dhe informacionin nga Regjistri i Kredive që i referohen një personi fizik të identifikuar ose një personi fizik të identifikueshëm, ndërsa person i identifikueshëm është personi, identiteti i të cilit mund të përcaktohet drejtpërdrejt ose tërthorazi, veçanërisht në bazë të numrit amzë të qytetarit.

3.6. "E dhënë e gabuara" do të thotë e dhënë personale e paplota, e parregullt, e pasaktë ose e papërditësuar.

3.7. "Korrigjim i të dhënave të gabuara" nënkupton shtimin, ndryshimin ose ndërprerjen e përdorimit të të dhënave të gabuara."

3. Në pikën 7, paragrafët 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

"Bankat dhe bankat e kursimeve janë të detyruara të vendosin rregulla dhe procedura të qarta për sigurimin e saktësisë së të dhënave dhe informacionit të paraqitur në Regjistrin e Kredive, duke përfshirë korrigjimin e të dhënave të gabuara.

Nëse klienti - person fizik i paraqet kërkesë me shkrim bankës ose kursimores, për korrigjimin e të dhënave të pasakta, me dëshmi që të dhënat e tij personale në Regjistrin e Kredive janë të pasakta, banka ose kursimorja është e detyruar të korrigjojë të dhënat e pasakta.”

4. Pas pikes 8 shtohen dy pika të reja 8-a dhe 8-b, si më poshtë:

"8-a. Për korrigjimin e të dhënave të pasakta në Regjistrin e Kredive, bankat dhe kursimoret shkruajnë mesazhin elektronik - Kërkesë për korrigjim, brenda pesë (5) ditëve pune pas pranimit të kërkesës së pikës 7, paragrafi 3 të këtij vendimi.

Banka Popullore ia kthen kërkesën e pakompletuar bankës ose kursimores brenda dy (2) ditëve pune pas pranimit të kërkesës së paragrafit 1 të kësaj pike.

Bankat dhe kursimoret janë të detyruara që kërkesën ta plotësojnë brenda dy (2) ditëve pune pas marrjes së njoftimit nga Banka Popullore sipas paragrafit 2 të kësaj pike.

Korrigjimi i të dhënave të pasakta në Regjistrin e Kredive bëhet brenda tri (3) ditëve pune nga marrja e kërkesës së plotë.

Pas korrigjimit dërgohet menjëherë një mesazh elektronik - Njoftim për korrigjimin deri te të gjitha bankat dhe kursimoret.

Përmbajtja e mesazheve elektronike të paragrafëve 1 dhe 5 të kësaj pike përcaktohet në Udhëzimin e pikës 13 të këtij vendimi.

8-b. Bankat dhe kursimoret janë të detyruara të tërheqin gjendjen e re nga Regjistri i Kredive, për personin fizik për të cilin kanë marrë Njoftimin për korrigjim sipas pikës 8-a, paragrafi 5 të këtij vendimi, të nesërmen nga dita e marrjes së njoftimit, duke zbatuar dispozitat e pikës 10 të këtij vendimi.”

5. Pika 9 ndryshohet si më poshtë:

"9. Të autorizuarit e pikës 14 të këtij vendimi qasen në të dhënat dhe informacionet në Regjistrin e Kredive pas identifikimit paraprak dhe verifikimit të qasjes së autorizuar. Banka Popullore evidenton qasjet e personave të autorizuar”.

6. Pas pikës 12 shtohet kreu i ri: **„IV-A. MËNYRA E QASJES SË PERSONIT FIZIK NË TË DHËNAT PERSONALE NË REGJISTRIN E KREDIVE”** dhe dy pika të reja 12-a. dhe 12-b., si më poshtë:

„IV-A. MËNYRA E QASJES SË PERSONIT FIZIK NË TË DHËNAT PERSONALE NË REGJISTRIN E KREDIVE

12-a. Çdo person fizik ka të drejtë të qasjes në të dhënat personale në Regjistrin e Kredive, për periudhën e fundit raportuese, duke përdorur shtojcat 1, 2 dhe 3, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Për marrjen e të dhënave sipas paragrafit 1 të kësaj pike, personi fizik paraqet kërkesë me shkrim në Bankën Popullore, të dhënë në shtojcën 1 të këtij vendimi.

Kërkesën e paraqet personalisht personi fizik ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar. Formulari i prokurës, i cili jepet vetëm për marrjen e të dhënave nga Regjistri i Kredive, është dhënë në shtojcën 2 të këtij vendimi.

Formulari i kërkesës dhe prokura mund të merren në Bankën Popullore ose të shkarkohen nga faqja e internetit e Bankës Popullore.

Kërkesës i bashkëngjitet fletëpagesa për kompensimin e paguar, në përputhje me tarifën e kompensimeve për shërbimet që i kryen Banka Popullore.

12-b. Pas kërkesës së paraqitur, lëshohet Raport nga Regjistri i Kredive, i dhënë në shtojcën 3 të këtij vendimi. Raporti përpilohet deri pesë (5) ditë pune nga dita e pranimi të kërkesës.

Raporti nga Regjistri i Kredive i lëshohet personalisht personit fizik ose përfaqësuesit të pikës 12-a, paragrafi 3 të këtij vendimi, identiteti i të cilit konfirmohet duke paraqitur dokumentin e vlefshëm të identifikimit (letërnjoftim/pasaportë). Për mbrojtjen e të dhënave personale, Raporti nga Regjistri i Kredive lëshohet në zarf të mbyllur, të vulosur dhe të mbrojtur në përputhje me rregulloren për lëndën arkivore.”

7. Në pikën 13, pika zëvendësohet me presje dhe shtohen fjalët: “si dhe mënyra e korrigjimit të të dhënave të pasakta”.

8. Ky vendim hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë.

V nr. 02-15/IV -3/2015
30 prill 2015
Shkup

Guvernatori
dhe kryesuesi
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov

SHTOJCË 1

Drejtuar:

Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut

KËRKESË

Unë _____, me
NVAQ _____, me adresë banimi _____

kërkoj të më informoni për të dhënat që përpunohen për mua në përmbledhjen e të dhënave personale –
Regjistri i Kredive, me gjendjen e fundit në dispozicion.

Të dhënat rredh përfaqësuesit: emri dhe mbiemri _____, numri i
letërnjoftimit ose i pasaportës _____, me adresë vendbanimi _____

Telefon për kontakt: _____

Pajtohem që të dhënat personale të specifikuara në kërkesë të përdoren për marrjen e Raportit nga
Regjistri i Kredive, i cili mbahet nga kontrolluesja, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në: _____
Data

KËRKUESI:

Udhëzim për pagesë

Pagesa të bëhet në formularin PP 10 me këto të dhëna: Thirrje e numrit: **12071180**

Qëllimi i dërgesës: Të dhëna nga Regjistri i Kredive

Emri i pranuesit: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Banka e Pranuesit: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Llogaria: **10000000001103**

Shuma e pagesës: **590,00** denarë

Kodi: **930**

**Kërkesa dorëzohet në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut
duke e bashkangjitur origjinalin e fletëpagesës (formulari PP 10). Gjatë marrjes së
përgjigjes së kërkesës duhet të tregohet dokumenti personal i identifikimit të
kërkuesit/përfaqësuesit**

SHTOJCË 2

PROKURË

Personi fizik

Emri dhe mbiemri _____

Adresa e banimit _____

NVAQ _____, **autorizon**

Përfaqësuesin

Emri dhe mbiemri _____

Adresa e banimit _____

numri i letërnjoftimit ose i pasaportës _____

Në emër dhe për llogari të personit fizik t'i ndërmarrë të gjitha veprimet para Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë, në lidhje me dhënien e Raportit nga Regjistri i Kredive për nevojat e

_____.

(emri dhe mbiemri i personit fizik - autorizues)

Kjo prokurë duhet të jetë e noterizuar dhe nuk mund të përdoret për qëllime të tjera.

(emri dhe mbiemri i personit fizik - autorizues)

Data: _____

Vendi: _____



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

"PËR PËRDORIM TË BRENDSHËM"

Drejtoria e Mbikëqyrjes së Jashtme dhe e Licencimit

Shkup, viti: _____

Nr.

Drejtuar:

Raport nga Regjistri i Kredive

Të nderuar!

Në lidhje me kërkesën tuaj për marrjen e të dhënave nga Regjistri i Kredive, ju informojmë se në Regjistrin e Kredive, të cilin Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë e ka themeluar dhe menaxhuar në përputhje me nenin 39 të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12 dhe 43/14), për ju janë përpunuar këto të dhëna:

1. Emri dhe mbiemri
2. Numri i amzës
3. Ekspozimi në _____ banka/kursimore
4. Kërkesa të shlyera nga evidence e bilancit në _____ banka/kursimore
5. Garanton në _____ banka/kursimore
6. Data e fundit e paraqitjes së të dhënave personale

Bankat dhe kursimoret dërgojnë të dhëna dhe informacione në Bankën Popullore për mbajtjen e Regjistrit të Kredive. Përdoruesit e Regjistrit të Kredive janë Banka Popullore dhe bankat e kursimoret që kanë marrë leje për themelim dhe funksionim, nga guvernatori i Bankës Popullore.

Në përputhje me Vendimin për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të Regjistrit të Kredive ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 186/13), bankat janë të detyruara të dërgojnë të dhëna për: bankat vendase dhe të huaja, jorezidentët, institucionet financiare vendore jobankare, personat e tjerë juridikë jofinanciarë vendorë me ekspozim total ndaj rrezikut të kredisë prej mbi 300 mijë denarë, si dhe për personat fizikë dhe shitësit me pakicë me ekspozim total ndaj rrezikut të kredisë prej mbi 5 mijë denarë.

Kursimoret duhet të dërgojnë të dhëna individuale për të gjithë personat juridikë me ekspozim total ndaj rrezikut të kredisë prej mbi 50 mijë denarë dhe për të gjithë personat fizikë dhe shitësit me pakicë me ekspozim total ndaj rrezikut të kredisë prej mbi 5 mijë denarë.

Banka Popullore i shfrytëzon të dhënat nga Regjistri i Kredive si pjesë e zbatimit të funksionit të saj mbikëqyrës, nga aspekti i analizimit të rrezikut të kredisë ndaj të cilit janë të ekspozuara bankat dhe kursimoret në punën e tyre. Bankat dhe kursimoret përdorin të dhënat nga Regjistri i Kredive si një ndihmë në vlerësimin e aftësisë kreditore të çdo klienti të ri ose ekzistues.

Vërejtje: Të dhënat e përfshira në Regjistrin e Kredive nuk mund të jenë baza e vetme për marrjen e një vendimi gjyqësor ose vendimi tjetër që prodhon efekt juridik ndaj një personi ose prek ndjeshëm këtë person. Në rast të të dhënave të pasakta, duhet t'i drejtoheni bankës/kursimores që ka dërguar të dhënat e pasakta dhe e cila duhet të bëjë ndryshimet e duhura në përputhje me Vendimin për përmbajtjen dhe mënyrën e funksionimit të Regjistrit të Kredive.

Përpiloi:

Drejtori:
